Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

TREGU I DREDHËZËS

Prill, 2015

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

ANALIZA E TREGUT TË DREDHËZËS

Prill, 2015

Parathënje

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, një ndër detyrat kryesore ka analizimin e produkteve bujqësore e një e tillë është edhe analiza e tregut të dredhëzës, e cila shpjegon më së miri gjendjen e tregut të dredhëzës në Kosovë duke prekur çdo detaj që i përket kësaj kulture.

Kjo analizë është bërë duke ndërthurrur shumë akterë të cilët ndihmuan në kompletimin e saj, së pari vizita fermerëve nga regjione të ndryshme të Kosovës të cilët ishin shumë të hapur rreth çdo pyeteje gjatë analizimit të kostos së prodhimit, pastaj grupi i ekspertëve të pemtarisë, të cilët ishin shumë të hapur me komente dhe propozime rreth kësaj analize.

Kjo analizë e finalizuar, vjen si një produkt bashkëpunimi mes departamentit të Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore si dhe departamenteve të ndryshme të MBPZHR-së.

Tregu i dredhëzës

Sipas të dhënave të Agjencionit të Statistikave të Kosovës në vitin 2013 në Kosovë janë mbjellur 148 ha me dredhëz. Sipërfaqja e mbjellur në vitin 2013 përfaqëson njëherit edhe sipërfaqen më të madhe të kultivuar me dredhëz në periudhën '09-'13. Në këtë periudhë mesatarisht 0.9% e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellur me fruta ka qenë e mbjellur me dredhëz. Kosova për të përmbushur nevojat vendore importon gjithashtu një sasi të konsiderueshme të dredhëzës.

1 Prodhimtaria vendore

Në vitin 2013 sipas të dhënave të Agjencionit të Statistikave të Kosovës prodhimtaria e dredhëzës ka qenë 465 ton. Për tu përmbushur nevojat vendore Kosova ka importuar edhe 214 ton dredhëza të freskëta ndërsa nëse marrim në konsideratë edhe sasinë e dredhëzës prej 25 ton që është importuar si e procesuar sasia e përgjithshme e importit të dredhëzës arrin në 239 ton. Gjatë kalkulimit të sasisë së importit të dredhëzës si vit për kalkulim nuk është përdorur viti kalendarik mirëpo të dhënat vjetore janë llogaritur nga muaji Prill kur fillon sezona e vjeljes së dredhëzës deri në muajin Mars të vitit tjetër kur edhe fillon sezona tjetër.

2 Zhvillimi i tregtisë

Kosova për të përmbushur nevojat vendore për konsum vazhdimisht importon dredhëz gjatë kohës që prodhimi vendor nuk është i pranishëm në treg. Gjatë muajve që Kosova ka prodhimtari të dredhëzës një sasi e prodhmit edhe eksportohet.

2.1 Importi i dredhëzës

Në vitin 2013 Kosova ka importuar 214 ton dredhëza të freskëta që krahasuar me vitin 2012 sasia e importuar është rreth 16% më e lartë. Ndërsa nga Prilli 2014 deri në Dhjetor importi ka arritur në 120 ton. Vlera e importit të dredhëzës së freskët në vitin 2013 ka arritu në 213,262 €.

Shikuar në aspektin kohor që nga viti 2007 importi i dredhëzës ka shënuar ngritje dhe rënie të lehta e kjo ka ndodhur në varshmëri nga disponueshmëria e prodhimit vendor ku kryesisht në rastet kur prodhimtaria është zvogëluar importi është rritur dhe e kundërta, ndërsa në vitin 2013 njëkohësisht është rritur edhe prodhimtaria vendore edhe importi.

Figura 1: Import i dredhëzës 2005-2014, në metrik ton



Burimi: MBPZHR-DAESB

Në vitin 2013 vlera e importit në total duke përfshirë importin e dredhëzës së freskët dhe importin në ekuivalent të dredhëzës ka arritur në 236 mijë €, ku pjesëmarrje dukshëm më të lartë ka vlera e importit të dredhëzës së freskët. Viti 2013 paraqet edhe vlerën më të lartë të importit sepse edhe sasia e importuar është më e lartë krahasuar me vitet paraprake

Figura 2: Importi i dredhëzës 2005-2014, në 1000 €



Burimi: MBPZHR-DAESB

Në vitin 2013 përkatësisht nga Prilli i vitit 2013 deri në Mars të vitit 2014 dredhëza është importuar kryesishtë nga Greqia (92%), nga Maqedoni dhe Shqipëria (6%) si dhe pjesa tjetër prej 2% nga vendet e tjera si: Serbia, Gjermania, Kina, Italia dhe Franca.

Figura 3: Import i dredhëzës 2013/2014 sipas vendeve



Burimi: MBPZHR-DAESB

Në periudhën Prill 2012 – Mars 2013 dredhëza është importuar kryesisht nga Greqia dhe Maqedoni si dhe pjesa tjetër nga Spania dhe vendet e tjera si Serbia, Shqipëria, Kina, Holanda etj. Mund të themi se në periudhën dy vjeçare duke filluar nga Prilli 2012 deri në Mars 2014 sasia më e madhe e dredhëzës duke përfshirë edhe importin në ekuivalent të dredhëzës është importuar nga Greqia dhe Maqedonia.

2.2 Eksporti i dredhëzës

Në vitin 2013 Kosova ka eksportuar 7 ton dredhëza përkatësisht ekuivalent të dredhëzës që krahasuar me vitin 2012 sasia e eksportuar është dukshëm më e vogël. Ndërsa nga Prilli 2014 deri në Dhjetor eksporti ka arritur në 19 ton.

Shikuar në aspektin kohor sasia e dredhëzës së eksportuar ka shënuar luhatje më të mëdha. Sasia më e madhe e ekportit ka qenë në vitin 2011 dhe vitin 2012. Në vitin 2014 gjithashtu vërehet një trend rritës i eksportit.

Figura 4: Eksporti i dredhëzës 2005-2014, në metrik ton



Burimi: MBPZHR-DAESB

Vlera e eksportit të dredhëzës në vitin 2013 ka arritur në 13,572 €. Viti 2012 paraqet edhe vlerën më të lartë të eksportit sepse edhe sasia e eksportuar është më e lartë krahasuar me vitet paraprake ndërsa në vitin 2014 duke qenë se sasia e eksportuar ka trend rritës kjo rezulton edhe me vlerë më të lartë të eksportit. Në periudhën 2005-2014 eksport në ekuivalent të dredhëzës ka pasur vetëm gjatë vitin 2013.

Figura 5: Eksporti i dredhëzës 2005-2014, në 1000 €



Burimi: MBPZHR-DAESB

Në vitin 2013 përkatësisht nga Prilli i vitit 2013 deri në Mars të vitit 2014 dredhëza është eksportuar kryesisht në Rumani (52%) dhe Hungari (47%) dhe një përqindje shumë e ulët në Maqedoni (1%). Sasia e eksportuar e dredhëzës e paraqitur në figurën më poshtë është eksport në ekuivalent të dredhëzës e jo dredhëz si produkt i freskët.

Figura 6: Exporti i dredhëzës 2013/2014 sipas vendeve



Burimi: MBPZHR-DAESB

Për dallim nga viti 2013 ku Kosova ka eksportuar 186 ton dredhëz prej të cilës sasi, pjesën më të madhe në Rumani dhe Hungari në vitin 2012 Kosova eksportoi vetëm në Serbi sasinë prej 35 ton. Gjithashtu për dallim nga viti 2013 kur e tërë sasia e eksportuar ishte në ekuivalent të dredhëzës në vitin 2012 sasia prej 35 ton ishte eksportuar në Serbi si dredhëz e freskët.

2.3 Bilanci tregtar i dredhëzës

Nga figura më poshtë shihet se vlera e bilancit tregtar ka qenë më e larta në vitin 2013 prej 223 mijë €, ndërsa nëse e shikojmë në aspektin e raportit në mes të eksportit dhe importit mbulueshmëria më e lartë ka qenë në vitin 2012 me 42% ndërsa ajo më e ulëta në vitin 2006 me vetëm 0.3%. Në vitin 2014 bazuar në situatën deri në Dhjetor pritet që mbulueshmëria e importit me eksport të jetë më e lartë.

Figura 7: Vlera e bilancit tregtar për dredhëzën



Burimi: MBPZHR-DAESB

3 Çmimet e tregut

Tregu i dredhëzës në Kosovë është një treg për të cilin ka një kërkesë të madhe, prandaj plasimi i dredhëzës në treg nuk paraqet ndonjë problem për kultivuesit e saj. Gjithashtu në tregun tonë dominojnë edhe prodhimet e importit për të përmbushur kërkesën gjatë mungesës së prodhimit vendor të dredhëzës por edhe kur ka dredhës vendore dredhëzat e importit janë të pranishme prap në treg.

3.1 Çmimet në tregun vendor

Plasimi në treg i dredhëzës vendore fillon qysh nga muaji Prill e kështu vazhdon deri në muajin Shtator, varur nga kushtet klimatike që e mundësojnë një cikël të tillë. Çmimet e dredhëzës varësisht nga regjionet nuk dallojnë shumë ato sillen nga 1 deri në 2.50 €. Figura në vijim tregon lëvizshmërinë e çmimeve vendore të dredhëzës gjatë vitit 2013 dhe 2014.

Figura 8: Çmimet vendore për një kg dredhëz, 2013-2014



Burimi: MBPZHR-DAESB

Qysh nga muaji Prill pra kur fillon sezona e prodhimtarisë së dredhëzës vendore çmimet janë më të ulëta. Gjatë vitit 2013, çmimi ka vazhduar të jetë relativisht i njejtë për dallim nga muaji Shatator ku çmimi i dredhëzës është ngritur në 2.35 €, ndërsa gjatë vitit 2014 duke ju referuar sezonës së njejtë vërejmë se çmimi i dredhëzës është ngritur gjatë muajit Gusht në 2.58 € duke rënë në muajin Shtator në 1.46 €, këto çmime i referohen gjithmonë sasisë 1 kg.

3.2 Çmimet e importit

Çmimet e importit në tregun e Kosovës për kulturën e dredhëzës gjatë vitit 2013 janë sjellur nga 1.59 € deri në çmimin prej 5.42 €, ky çmim i referohet muajit Dhjetor por shikuar në përgjithësi ngritja e çmimit të dredhëzës fillon nga muaji Tetor pra nga momenti kur dredhëza vendore nuk është e pranishme më në treg. Sa i përket vitit 2014, në periudhën kur ka mungesë të dredhëzës vendore, çmimet janë të larta dhe variojnë nga 3 deri në 5 €, kjo ndodh në kohën kur sezona e dredhëzës vendore nuk ka filluar ende dhe vazhdon me trend të njejtë edhe gjatë periudhës Tetor–Dhjetor. Në vitin 2014 në periudhën kur në treg ka pasur dredhëz vendore, janë përmbushur nevojat për konsum dhe nuk ka pasur import të dredhëzës prandaj edhe në grafikun e mëposhtëm nuk janë të paraqitura çmimet e importit për periudhën Prill - Gusht.

Figura 9: Çmimet e importit pë një kg dhredhëz të importuar



Burimi: MBPZHR-DAESB

4 Madhësia e tregut

Tregu i përgjithshëm i dredhëzës në Kosovë në vitin 2013 vlerësohet të ishte rreth 697 ton. Kjo përfshinë gjithë prodhimtarinë vendore si dhe importin dhe eksportin e dredhëzës si produkt i freskët si dhe si produkt i procesuar. Tregu vendor vlerësohet se mbulon rreth 67% të nevojave për konsum të dredhëzës ndërsa pjesa tjetër prej 33% mbulohet nga importi.

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare të prodhimtarisë vendore si dhe në të dhënat e tregtisë rezulton që konsumi i përgjithshëm i dredhëzës për kokë banori në Kosovë është rreth 400 gr.

5 Kostoja e prodhimit të dredhëzës

Sa i përket kostos së prodhimi të dredhëzës, tabela në vijim paraqet të dhënat e detajuara për kulturën e dredhëzës në tri vitet e prodhimit në sipërfaqe prej 10 ari, kjo kosto i është referuar sipërfaqes 10 ari sepse në Kosovë shumica e fermerëve kultivojnë në siperfaqe të tilla.

Poashtu, është kalkuluar edhe fuqia punëtore, kur puna kryhet nga anëtarët e familjes si dhe kur puna paguhet sepse në Kosovë, shumicën e rasteve fermerët punën e anëtarëve të familjes nuk e kalkulojnë dhe kjo ndikon në ngritjen e fitimit të tyre dhe nuk pasqyron fitimin real.

Të ardhurat neto, për tri vite në sipërfaqe prej 10 ari janë 13,663 € nëse llogaritet se e tërë fuqia punëtore paguhet ndërsa në rast se vetëm 20 % e punës paguhet të ardhurat janë më të larta përkatësishtë 14,794 €.

Gjatë vitit të dytë rendimenti është më i lartë dhe të ardhuart neto janë 4,796 €. Zakonisht gjatë ciklit të kultivimit të dredhëzës kulmi i rendimentit është në vitin e dytë të prodhimit, ndërsa viti i parë dhe vitit i tretë janë të përafërt kjo spjegohet edhe në kalkulimet e mëposhtëme ku mesatarja e rendimetit për 10 ari gjatë tri viteve është rreth 3,083 kg.

Në kalkulimet e paraqitura në tabelën e mëposhtme kostoja e fidanit është llogaritur 0.05 € që paraqet koston e fidanit të cilin fermeri e përgatit vet, ndërsa në rast se fermeri blen fidanin vendor ai mund ta gjejë në treg me çmim mesatar rreth 0.10 €. Kjo do të ndikonte që të rritej kostoja e inputeve dhe automatikisht edhe të ardhurat neto do të ishin më të ulta.

Tek kategoria e zhvlerësimit e paraqitur në kalkulim është e përfshirë kostoja e investimit e ndarë në vite si dhe amortizimi i makinerisë në atë mënyrë që nga amortizimi i përgjithshëm një pjesë i është ndarë kulturës së dredhëzës, përkatësishtë sipërfaqes prej 10 ari.

Tabela 1: Kosto e prodhimit të dredhëzës në sipërfaqe 10 ari

	Njësia	Viti 1-rë	Viti 2-të	Viti 3-të
TË ARDHURAT				
Dredhëza	kg/10 ari	3,000.00	3,250.00	3,000.00
Totali i të ardhurave	**Euro**	**6,000.00**	**6,500.00**	**6,000.00**
KOSTO VARIABILE				
Totali i inputeve	Euro	666.23	810.84	759.73
MARZHA E KONTRIBUTIT	**Euro**	**5,333.77**	**5,689.16**	**5,240.27**
FUQIA PUNËTORE				
Puna me pagesë (20%)	Euro	84.75	101.25	96.75
MARZHA PARA ZHVLERËSIMIT	**Euro**	**5,249.02**	**5,587.91**	**5,143.52**
Zhvlerësimi	Euro	413.66	386.02	386.02
TE ARDHURAT NETO (Kur 80 % të punëve kryhen nga anëtarët e familjes)	**Euro**	**4,835.35**	**5,201.88**	**4,757.49**
Puna nga anëtarët e familjes (80%)	Euro	339.00	405.00	387.00
TE ARDHURAT NETO	**Euro**	**4,496.35**	**4,796.88**	**4,370.49**

Burimi: MBPZHR-DAESB

5.1 Ndikimi i prodhimtarisë së dredhëzës në punësim dhe mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës

Duke ju referuar të dhënave të fuqisë punëtore të përdorura në modelin e kostos së prodhimit ku është kalkuluar fuqia punëtore e angazhuar në sipërfaqe prej 10 ari, mund të themi se një punëtor me orar të plotë të punës mund të kujdeset apo të punoj mesatarisht nga 70-80 ari gjatë një viti.

Kjo varet kryesisht nga teknikat e përdorura gjatë investimit, ku sa më tepër të përdoret makineria e avancuar aq më tepër rritet sipërfaqja për të cilën mund të kujdeset një punëtor me orar të plotë të punës.

Duke marr parasysh sipërfaqen e mbjellur me dredhëz prej 148 ha rezulton se momentalisht mund të themi se në sektorin e dredhëzës janë të punësuar rreth 200 persona të rregullt me orar të plotë të punës.

Nëse sipërfaqja e mbjellur me dredhëz në Kosovë rritet, për çdo 10 ha të sipërfaqes së shtuar do të krijoheshin rreth 14 vende të rregullta të reja të punës me orar të plotë.

5.2 Mbështetja e prodhimtarisë së dredhëzës

Prodhimtaria e dredhëzës në Kosovë është mbështetur përmes granteve investive duke filluar nga viti 2012 ndërsa në vitin 2015 dredhëza do të mbështetet edhe përmes pagesave direkte.

5.2.1 Pagesat direkte për dredhëz

Objektivat që tentohet të arrihen përmes pagesave direkte janë: rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit dhe zvogëlimi i kostos së prodhimit, e kjo do të ndikoj në rritjen e të hyrave dhe përmirësimin e aftësisë konkuruese.

Fermerët që janë kultivues të dredhëzës për të përfituar nga programi i pagesave direkte duhet të kenë të mbjellura së paku 0.25 ha me dredhëz dhe kjo sipërfaqe duhet të jetë në një parcelë të vetme. Në rast se fermeri merr me qira gjithashtu edhe sipërfaqja e marr me qira duhet të jetë së paku 0.25 ha e pandarë, e dokumentuar përmes kontratës si dhe e kontraktuar në periudhë prej së paku një vit. Fermerët do të mbështeten në shumë prej 400 €/ha.

5.2.2 Masat e zhvillimit rural që përkrahin sektorin e pemëve – dredhëzën

Në kuadër të masave të zhvillimit rural në vitin 2015 dredhëza do të përkrahet në kuadër të masës 101, **Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore.**

Objektiva të përgjithshme të kësaj mase janë përmirësimi i aftësisë konkurruese dhe zëvendësimi i importit, krijimi i vendeve të reja të punës, përkrahja e fermerëve me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së, përkrahja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial përmes zhvillimit të kapitalit fizik dhe adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme.

Objektivat specifike që kanë të bëjnë me sektorin e pemëve janë: rritja e prodhimit të pemëve për qëllime komerciale; përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së; modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizmit modern; zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje për fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim; prodhimi i energjisë së ripërtëritshme dhe përmirësimi i integrimit të fermerëve me blerësit e prodhimeve bujqësore.

Për të përfituar përmes kësaj mase fermerët duhet që përveq kritereve të përgjithshme që shpallen në thirrjen për aplikim ata duhet të plotësojnë edhe disa kritere specifike për sektorin e pemëtarisë dhe serrave.

Fermeri në momentin e aplikimit duhet të dëshmojë posedimin e sipërfaqes bujqësore, në pronësi apo të marr me qira prej së paku 10 vjet dhe të ketë të regjistruar në Regjistrin e Fermave sipërfaqen prej së paku 0.25 ha me fruta manore, në këtë rast me dredhëz si dhe

madhësia minimale e ngastrës të jetë 0.10 ha.

Në rast se investon në makineri bujqësore dhe pajisje ose ndërtim dhe renovim të objekteve investimi duhet të përputhet me kapacitetet prodhuese. Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë duhet të dorëzojnë kopjen e çertifikatës fitosanitare për të dëshmuar gjendje shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Cimmunitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidane të importuara nga vendet e BE-së duhet të dorëzojnë kopjen e çertificates mbi gjendje shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, çertifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërrmarrjes importuese.

Përfituesit për ngritjen e pemishteve me pemë manore duhet ti ruajnë etiketat e fidanëve të blerë me tufa për ti paraqitur para kontrolluesve të AZHB-së me rastin e kontrollit.

Nëse fermeri aplikon për investime në depo për pemë fermeri duhet të dëshmoj posedimin e sipërfaqes së tokës së punueshme, në pronësi apo të marr me qira për së paku 10 vjet dhe të ketë të regjistruar në Regjistrin e Fermës sipërfaqen prej së paku 2 ha

Në rast të investimeve në ndërtimin e serrave të reja ekonomia bujqësore duhet të dëshmoj se ka së paku 0.10 ha tokë të punueshme të Regjistruar në Regjistrin e Fermave.

Vlera minimale e pranueshme për projekte për pemë manore është 3,000 € ndërsa vlera maksimale 120,000 €. Përkrahja publike është në nivelin 60% të shpenzimeve të pranueshme të investimit, ndërsa përkrahje shtesë prej 10% jepet për investime në zona malore dhe 5% për fermerë të rinj (40 vjeç apo edhe më të rinj). Shuma totale e ndarë për përkrahje të pemëve manore në vitin 2015 është 1,000,000 €

Investimet përfshijnë:

- investimet në ngritjen e permishteve të reja me pemë manore në sipërfaqe 0.25 ha;

- investimet në vendosjen e sistemit të ujitjes sipas praktikave efikase të ujitjes;

- investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;

- investime në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pasvjeljes dhe

- investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pasvjeljes, objekteve për vendosjen e makinave dhe objekteve për vendosjen e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe plehërave artificiale.

Përveç në kuadër të nënmasës për pemë dredhëza përkrahet edhe tek kategoria e serrave që ka të bëjë me investime për ndërtimin e serrave me pemë manore me madhësi minimale prej 0.1 ha si dhe vendosja e sistemit të ujitjes dhe pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike. Gjithashtu në kuadër të kësaj nënmase përkrahet edhe ndërtimi i

objekteve për trajtim pas vjeljes si dhe atyre për vendosjen e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe plehëra artificiale.

Përveç në kuadër të masës 101 dredhëza përkrahet edhe në kuadër të masës 103, **Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore.**

Kjo masë ka për qëllim që të rrisë konkurrueshmërin e sektorit agro-ushqimor, të ndikoj në zëvendësimin e produkteve të importuara si dhe përmirësimin e produktivitetit.

Objektiva të përgjithshme të kësaj mase janë përmirësimi i aftësisë konkuruese përmes rritjes së produktivitetit dhe përdorimit të teknologjive të reja, përkrahja e bujqve me qëllim të përafrimit me standardet e BE-së dhe përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, forcimi i lidhjeve me prodhimin primar si dhe prodhimi i energjisë së ripërtëritshme me qëllim të ruajtjes së mjedisit.

Objektivat specifike të kësaj mase janë: implementimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së, përmirësimi i teknologjive të prodhimit si dhe objekteve përcjellëse, diversifikimi i aktiviteteve, përmirësimi i marketingut dhe përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

Përfitues në kuadër të kësaj mase mund të jenë vetëm ndërrmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që kategorizohen sipas legjislacionit në fuqi dhe që plotësojnë standardet minimale kombëtare.

Përfituesit e mundshëm janë subjektet që kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku dy vjet para datës së aplikimit dhe janë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ndërsa në rast të investimit në qendra grumbulluese dhe paketuese kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku 500 tonë.

Investimet e pranueshme për dredhëzën në kuadër të kësaj mase janë investimet lidhur me përpunimin e dredhëzës dhe shpenzimet e marketingun për promovimin e tyre.

Në kuadër të shpenzimeve të marketingut hyjnë përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve, prodhimi i audio dhe videospoteve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre. Vlera e shpenzimeve të marketingut është e kufizuar në 5% të investimeve të pranueshme.

Në kuadër të investimeve të pranueshme hyjnë: ndërtimi dhe renovimi i objekteve (blerja e pronës është e përjashtuar), blerja e makinerive dhe pajisjeve duke përfshirë programet kompjuterike, shpenzimet e tjera që lidhen me projektin si shpenzimet për arkitekt, inxhinier dhe shpenzimet për studime paraprake si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve paraprake janë të pranueshme deri në 7% por jo më shumë se 20,000 € të shpenzimeve të pranueshme për projekt kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% por jo më shumë se 5,000 € të shpenzimeve të pranueshme për projekt. Të pranueshme janë edhe shpenzimet administrative edhe nëse ato ndodhin para nënshkrimit të kontratës

vetëm në rast se projekti është përzgjedhur dhe kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Vlera minimale e pranueshme për projekt është 40,000 € ndërsa vlera maksimale 400,000 €. Përkrahja publike është në nivelin 50% të shpenzimeve të pranueshme të investimit, ndërsa vetëm për investimet që kanë të bëjnë me trajtimin e mbetjeve përkrahja rritet në 60%. Pagesa bëhet me dy këste ku pjesa e parë prej 50% jepet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës ndërsa pjesa tjetër pas përfundimit të investimit të përgjithshëm. Në total për përkrahje të pemëve dhe perimeve në kuadër të kësaj mase janë ndarë 1,400,000 €.

6 Promovimi dhe sfidat

Që nga viti 2010 ka filluar mbajtja e "Ditës së dredhëzës" e cila tani ka fituar një karakter nacional dhe po ndikon në sensibilizimin e opinionit për prodhimtarinë e kësaj kulture.

Edhe pse ka të arritura të konsiderueshme eksitojnë edhe disa probleme të cilat vazhdojnë të mbesin sfida pë kultuvuesit e dredhëzës si:

- Mungesa e fidanëve cilësore të prodhuar sipas standardeve të larta ndërkombëtare
- Rritja e sipërfaqeve po bëhet me fidane të cilësisë së dobët dhe të pa kontrolluar
- Mungesa e masave adekuate për mbrojtje kundër ngricave pranverore
- Sezoni i shkurtë i mbulimit te tregut (dalja me vonesë në treg dhe mos prania në treg gjatë tërë vitit)
- Procesi i përpunimit është në hapat e parë.

7 Konkluzionet

Nga të gjitha të dhënat e paraqitura në analizën e tregut të dredhëzës mund të konkludojmë se në Kosovë sipërfaqja e mbjellur me dredhëz është rritur në vazhdimësi, mirëpo për tu plotësuar nevojat vendore Kosova vazhdimisht edhe ka importuar dredhëz si produkt i freskët dhe i procesuar. Nevoja për import ka rezultuar nga mungesa e prodhimit vendor në periudhën kur nuk është sezona e saj ndërsa në sezonë importi është zvogëluar në minimum ose nuk ka pasur pothuajse fare import.

Rritja e prodhimtarisë nuk do të ndikonte drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së importuar mirëpo nëse Kosova ka më tepër prodhim dhe e rrit eksportin e dredhëzës kjo do të ndikonte në uljen e vlerës negative të bilancit tregtar për këtë kultur e njekohësishtë edhe në vlerën e përgjithshme të bilancit tregtar.